



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE



BSA

Bailiff Services Albania

Tiranë më, datë 01.03.2021

Nr. 631 .Prot
Nr.1127.Regj

URDHËR
PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Bisnesit, Tiranë.

Pranë zyrës përmbarimore private "Bailiff Services Albania" sh.p.k, është depozituar kërkesa e palës kreditore Credins Bank sh.a. sëbashku me Urdhërin e Ekzekutimit nr.1809 datë 26.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të lëshuar për titullin ekzekutiv Kontratë Kredie Bankare nr.0652 datë 07.12.2010 me palë:

- Kreditor: Credins Bank sh.a.
- Debitor: Shoqeria "Kleit-08" shpk (ish "San Paolo Kleit")
- Dorëzanës: Kirzen Bushati, Desara Bushati, Pjetër Pacani dhe Marije Pecani
- Objekti: Kthim kredie

Në bazë të nenit 517 të K.Pr.Civile i është komunikuar palës debitore njoftimi për ekzekutim vullnetar. Me marrjen dijeni nga ana e palës debitore nuk është kryer asnjë veprim. Për rrjedhojë në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e zyrës përmbarimore është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit duke vendosur masën e sekuestros mbi llogaritë bankare të palës debitore. Duke qënë se palës debitore i është ekzekutuar i gjithë detyrimi, sipas urdhërit të ekzekutimit, duhet të procedohet me heqjen e masës së sekuestros konservative të urdhëruar nga ana e zyrës përmbarimore private Bailiff Services Albania shpk.

Në bazë të nenit 616/a të K.Pr.Civile, si dhe Ligjit Nr 26/2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJ

1-Qendrën Kombëtare të Bisnesit të heqë sekuestron konservative të urdhëruar me shkresën tonë Nr. 2343 Prot. Nr. 1127 Regj. datë 11.11.2020, si dhe me çdo shkresë tjetër të zyrës përmbarimore private "Bailiff Services Albania" sh.p.k me anë të së cilës është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros mbi aktivet e palës debitore;

- Shoqëria Kleit-08 shpk me NUIS L06727005M
- Kirzen Bushati PF me NUIS L57205025A
- Shoqëria Kleit Marvi shpk me NUIS L86821006B
- Kirzen Bushati PF me NUIS L86911003A

2-Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3-Personat që bëhen pengesë, do të pergjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile.

4-Ky urdher mbahet u komunikohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

Zyra Përbarimore Private "Bailiff Services Albania" sh.p.k
Përbarimes Gjyqësor Privat
ERION LLALLA

